



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu

Nr. I prot. 1262 Më 05.04.2024  
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC



**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**

**Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec**



**Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec**

**Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm  
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam  
Department of Economy, Development and Tourism**

---

# Raporti i punës

Janar–Mars, 2024



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm  
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam  
Department of Economy, Development and Tourism

DATË /A:	5.04.2024
PËR/ZA/TO :	z.Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
NGA/OD/FROM:	z.Erhan Morina, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i punës për periudhën janar-mars 2023



#### DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Raporti është i bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës.

Fushëveprimtaria e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në planifikimin e punës për vitin 2024. Në kuadër të DEZHT, gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar shumë aktivitete.

#### Aktivitetet e Drejtorisë;

-Në muajin janar, janë bërë të gjitha barazimet financiare në qira dhe në taksa afariste për vitin 2023, si dhe është bërë inkasimi i borxheve të trashëguara nga viti paraprak.

-Gjatë periudhës janar-mars në sektorin për ekonomi janë regjistruar të gjitha subjektet afariste prej librit kryesor të vitit 2023, në regjistrin e librit të vitit 2024.

Poashtu në fillim të vitit 2024, është bërë kalkulimi i ngarkesave në formë elektronike, përpilimi dhe analizimi i ngarkesave në taksë afariste komunale për vitin 2024 si dhe është bërë planifikimi i të hyrave për vitin 2024.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

-Gjatë periudhës raportuese janar-mars, Drejtoria për Ekonomi Zhvillim dhe Turizëm ka propozuar dhe ka inicuar në kuvend disa pika të rendit të ditës:

- Në muajin shkurt, është inicuar pika e rendit të ditës për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale në periudhë afatshkurtër deri në 25 vite, për vendosjen e paneleve solare dhe jemi në pritje të konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL;
- Poashtu në muajin shkurt, është inicuar pika e rendit të ditës për dhënien në shfrytëzim në periudhë afatshkurtër deri në 15 vite, të dy parcelave te Depot e Matreksit. Në këtë anka nd është shpallur një fitues dhe jemi në fazën përgatitjes së kontratës;
- Në muajin mars, në mbledhjen e rregullt të K.K Rahovec është prezantuar dhe është votuar pika e rendit të ditës për dhënien në shfrytëzim për periudhë afatshkurtë për 5 vite shtëpa e verës në Bërnjakë;
- Poashtu në muajin mars, është prezantur në K.K Rahovec, pikë informatë mbi menaxhimin e aseteve komunale për vitin 2023.

-Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, për vitin 2024 nga kjo ministri, me datë: 26.02.2024, Komuna e Rahovecit ka fituar grant në vlerë 200,000.00€ për projektin: “Ndërtimi i Ballkonit Panoramik mbi Qytet”. Vlera e parashikuar e këtij projekti është 320,117.00€.

-Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për financimin e fazës së dytë të parkut industrial në Opterushë dhe në këtë fazë MINT, do të financoj në vlerë 1,000,000.00€

## 1. Investimet Kapitale

**Në periudhën janar –mars të vitit 2023, janë zhvilluar punime në këto projekte:**

-Në Projektin “Ndërtimi i Lokaleve Afariste Zejtare në Rahovec”, gjatë periudhës janar-mars, janë përfunduar këto pozicione: pozicioni i fasadës gjysmë stukturale, vendosja e xhamave dhe aktualisht jemi në pozicionin e rregullimit të oborrit. Ky projekt pritet të përfundojë deri në fund të muajit prill.

-Ndërtimi i fazës së parë të Parkut Industrial në Opterushë, ka vazhduar edhe në tre mujin e parë të vitit 2024. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar punimet në pozicionet e ujrave atmosferik, në rrafshimin e

### KOMUNA RAHOVEC

parcelave, përgatitjen e rrugëve për fazën e dytë (për asfaltim) si dhe trjatimi i infrastruktures elektroenergjetike.

### 1.1 Sektori për Ekonomi

-Në zyren për taksa afariste, për periudhën raportuese janar-mars, janë përfunduar dhe janë dërguar me kohë ngarkesat e taksave afariste për vitin 2024 për të gjitha bizneset të cilat operojnë në Komunën e Rahovecit.

Në tabelën më poshtë po paraqesim të hyrat në taksa afariste për periudhën janar-mars 2024.

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat në taksa afariste në periudhën janar-mars 2024	15,102.50 €

### 1.2 Sektori për Zhvillim

-Evidenca e të hyrave dhe ngarkesës së qirasë të lokaleve afariste dhe pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit, sipas bazës së shfrytëzimit si pasuri e paluajtshme komunale me të cilat disponon Komuna e Rahovecit, mbahet në mënyrë të rregullt.

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, aktualisht i menaxhon tridhjetë e shtatë (37) kontrata.

Poashtu, në periudhën janar-mars 2024, janë lëshuar gjithsej (38) tridhjetë e tetë pëlqime të punës .

Të hyrat në qira për periudhën janar-mars janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat nga qiratë në TM1	23,989.92€

**KOMUNA RAHOVEC**

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

### 1.3 Zyra e QKRB-së:

-Raporti është i bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës. Evidenca e regjistrimit të bizneseve të komunës së Rahovecit, sipas bazës së programit online të ARBK-së, mbahet në mënyrë të rregullit.

**Tabela e kërkesave dhe e regjistrimit të bizneseve për periudhën janar-mars 2024:**

Nr.	Përshkrimi	Nr.
1	Biznese të reja	59
2	Informata të ndryshme	73
3	Vërtetim individual	10
4	Shuarje e njësisë	0
5	Shuarje të biznesit	6
6	NUI	20
7	Njësi e re	1
8	Ndryshim nga B.I në SH.P.K	1
9	Certifikatë duplikat	2
10	Ndërrim pronari, ndërrim i aktivitetit, ndërrim i adresave	31
11	Vërtetim i biznesit	1
12	Punë të ndryshme me palë	25
13	Lëndë të anuluar	1
	<b>Gjithsejt lëndë të kryera</b>	<b>230</b>

### 1.4 Menaxhimi i Asteteve komunale

-Sektori për asete komunale, ka regjistruar me kohë të gjitha transaksionet e vitit 2023, ndërsa për vitin 2024, për periudhën janar-mars, nuk ka pasur regjistrime për arsye të lëshimit me vonësë të sistemit SIMFK.

**KOMUNA RAHOVEC**

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Gjatë periudhës janar-mars zyra për menaxhimin e aseteve komunale, ka përgatitur pikë informuese në K.K Rahovec, mbi menaxhimin e aseteve jo financiare për vitin 2023.

## 1.5 Sektori i Turizmit

**Zyra për Informacione Turistike, i ka zbatuar detyrat dhe obligimet e muajit janar-mars, 2024 si në vijim:**

-Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me organizatën UNDP, në lidhje me Programin ReLOad2;  
-Përmes bashkëpunimit me UNDP, është mundësuar praktikë 3 mujore për 3 kandidat, dy nga kandidatët janë angazhar në Komunën e Rahovecit dhe një në shoqatën Hareja.

-Mbajtja e trajnimit “Standing Working Group (SWG) in the South-Eastern Europe”, lidhur me Promovimin dhe Marketingun e Turizmit përmes rrjeteve digjitale.

-Poashtu, në vazhdimësi janë kryer punë të cilat i shërbejnë promovimit të turizmit në Komunën e Rahovecit .

**Me respekt**

**KOMUNA RAHOVEC**

---

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm